

**KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**

Sot, më datë 29/10/2019, palët e mëposhtme:

Z. Fatmir Dervishaj, shtetas shqiptar, me nr. Personal G70526063R, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar (që më poshtë do të quhet "**Shitësi**").

DHE

Z. Sokrat Hila, shtetas shqiptar, me nr. Personal F50630023J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (që më poshtë do të quhet "**Blerësi**").

Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkerisht si "**Palët**".

Palët bien dakort të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Z. Fatmir Dervishaj është zotëruar i 100% të kapitalit të shoqërisë **East Holding Shpk**, me NUIS L72024009H, me seli në Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati Pegaso, Kati 7-8, Zyra nr. 30, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si "**Shoqëria**").

Z. Fatmir Dervishaj zotëron 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 (njëqind) LEKE, që përkon me 100% të kapitalit themeltar te **East Holding Shpk**.

**Neni 1
Objekti i Kontratës**

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 (njëqind) LEKE, që përkon me 100% të kapitalit themeltar te shoqërisë **East Holding Shpk**.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë kuoten e kapitalit të Shoqërisë.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 2
Çmimi dhe mënyra e pagesës**

- 2.1 Transferimi i kuotës së kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet përkundrejt pagesës prej:
- 100 (njëqind) LEKE ndaj Shitësit **Z. Fatmir Dervishaj**.
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.



benyelo me


**Neni 3
Kalimi i Pronësisë**

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotëruar i kuotës korresponduese me 100% të kapitalit të Shoqërisë, titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me të, dhe pëfitues i fitimeve të Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

**Neni 4
Garancitë**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kuota e kapitalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate, është e transferueshme dhe e lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 5
Forca Madhore**

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardollos dispoze vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohej për shkak të forcave madhore dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

**Neni 6
Interpretimi i Kontratës në tërësi**

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

**Neni 7
Legjislacioni i zbatueshëm**

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

**Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

**Neni 9
Shpenzimet**

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të jenë në ngarkim të Blerësit.

**Neni 10
Ndryshimet**

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.



**Neni 11
Hyrja ne fuqi**

11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

**Neni 12
Gjuha e kontratës**

12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

Palët

SHITËSI

Fatmir Dervishaj

Z. Fatmir Dervishaj

EAST HOLDING
SHPK
L72024009H

BLERËSI

Z. Sokrat Hila

Z. Sokrat Hila

Angelos